

# Policia realizon kontroll në një shtëpi në Mitrovicë, sekuestron narkotikë e para të gatshme



24/02/2025 17:07

f

t

l

Policia e Kosovës, konkretisht Hetuesit e Drejtorisë së Hetimit të Trafikimit të Narkotikëve në Mitrovicë-Jug, pas pranimi të informacioneve të vlefshme nga terreni dhe në asistim të një patrulle policore pranë Stacionit Policor në Mitrovicë-Jug, kanë realizuar një kontroll të detajuar në një shtëpi dhe objektet përcjellëse në Fshatin Rekë, Mitrovicë-Jug.

Siç ka njoftuar Policia, gjatë kontrollit, si prova materiale janë sekuestruar:

- 8 qese me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, me peshë totale prej 8.8 gram.
- 75 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë totale prej 106.3 gram.
- 17 fara të bimëve narkotike Kanabis Sativa.
- 8 fishekë të kal. 7.92×57.
- 1 peshore digjitale.
- 1 mulli për bluarjen e marihuanës.
- 1010 euro para të gatshme.

“Në vendin e ngjarjes ka dalë Krimteknika Rajonale, e cila ka realizuar fotografimin, evidentimin, matjen dhe sekuestrimin e dëshmive. Gjatë kontrollit, i dyshuari nuk ka qenë i pranishëm në shtëpi, por i është lënë ftesë që të paraqitet në Polici për t’u marrë në pyetje. Lidhur me këtë rast, është informuar Prokurori Kujdestar pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda”, thuhet në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Hetimi për këtë rast është duke u kryer nga antidroga Mitrovicë-Jug në bashkëpunim me organet e drejtësisë. [/Lajmi.net/](#)

Fotografi nga ato që u sekuestruan:



Më shumë nga uebi

nativeGRAM  
by LogoMedia

Yll Limani ngjitet në skenë bashkë me

ARTIFICIAL INTELLIGENCE

BRIDGING THE GAP BETWEEN MACHINES AND HUMAN

Gjykata merr vendim, me kaq vite dënohet

"E goditi sëpatë në kokë"- Detaje

## Artikuj të ngjashëm

February 24, 2025  
Zveçan: Shpërndahen rreth 60 pako ushqimore për qytetarët në nevojë

February 24, 2025  
Publikohet video e rrallë me komandantin legjendar, Adem Jashari

lajmi.net

info@lajmi.net  
Tel: +383 49 131 131  
Gr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE

f

@

t

y

## Other Links

Fact-Checking Policy  
Ethics Policy  
Corrections Policy  
Ownership & Funding Information  
Editorial Team Information

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved [Privacy Policy](#)